



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Rrezart Domi** me datë **10.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, të vendosur ndaj shtetasit Rrezart Domi me vendimin nr. 57 datë 09.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Caktimin e një mase sigurimi tjetër si ajo e “arresti në shtëpi” të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112 dhe 263/1/c të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **712**, datë **12.12.2024**, vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit/ personit nën hetim **Rrezart Domi**.
2. Mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata për personin nën hetim Rrezart Domi të shpërblehet nga shteti, sipas tarifave përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, afat i cili do të fillojë nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 12.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar